



Njoftim/Thirrje

KONFERENCA SHKENCORE NDËRKOMBËTARE E III “Uji si burim i energjisë dhe mbrojtja e mjedisit: Balanca drejt së ardhmes së qëndrueshme”

Organizuar nga:

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (ASHAK) dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë (ASHSH)

e cila do të mbahet më 28 dhe 29 maj 2026

në Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës

Konferenca shkencore ndërkombëtare “Uji si burim i energjisë dhe mbrojtja e mjedisit:

Balanca drejt së ardhmes së qëndrueshme” që është konferenca e treta me radhë në lidhje me ujin dhe çështjet e energjisë dhe mjedisit, do të mbahet më 28 dhe 29 maj të vitit 2026 në ASHAK dhe do të bashkë-organizohet përsëri nga ASHAK dhe ASHSH.

Në këtë konferencë fokusi do të orientohet te rëndësia e ujit si faktor kyç për zhvillimin e qëndrueshëm të një vendi duke përfshirë shfrytëzimin e tij për nevoja ditore të qytetarëve të një vendi si edhe në aspektin e prodhimit të energjisë të pastër. Uji përdoret edhe në funksionimin e termocentraleve ndërsa ndërlidhja uji-energji përfshinë përdorimin e ujit për prodhimin e energjisë elektrike në hidrocentrale si dhe rolin që e ka uji në prodhimin e hidrogjenit të pastër, që paraqet një ndër vektorët kryesor të energjisë në të ardhmen. Konferenca synon të sjellë së bashku studiues, ekspertë të energjisë, përfaqësues të institucioneve publike dhe private, si dhe organizata mjedisore për të diskutuar mundësitë që ofron uji si burim i qëndrueshëm energjie, duke vënë theksin te shtimi i kapaciteteve të energjisë së rinovueshme, ndikimet mjedisore dhe ruajtja e ekosistemeve ujore.

Prandaj në kuadër të konferencës do të trajtohen, në mes tjerash, këto problematika:

- Burimet ujore në Kosovë, Shqipëri dhe në regjion dhe potenciali i shfrytëzimit të tyre për rritjen e kapaciteteve të prodhimit të energjisë elektrike,
- Shfrytëzimi i burimeve të ripërtitshme të energjisë për ruajtjen dhe bartjen e saj,
- Teknologjitë e avancuara që nevojiten për trajtimin adekuat të ujit, **vlerësimin e ndotësve të ndryshëm** dhe largimin e **tyre**.
- Menaxhimi i integruar i ujërave dhe zhvillimi i qëndrueshëm

Në këtë aktivitet ftohen të marrin pjesë ekspertët dhe të prezantojnë të arriturat e tyre në të gjitha fushat që i mbulon kjo konferencë.

Gjuha e Konferencës do të jetë gjuha shqipe dhe/ose ajo angleze

Afati për dorëzimin e abstraktit është 28 prill 2026. Dorëzimi i abstrakteve bëhet në adresën elektronike: fetahpodvorica@ashak.org. Abstraktet duhet të jenë në gjuhën shqipe dhe/ose në atë angleze.

Përzgjedhja e prezantimeve për konferencë do të bëhet në bazë të lidhjes së tyre me tematikat e konferencës dhe autorët do të njoftohen deri më 5 maj 2026.

Abstraktet e konferencës do të botohen në librin e konferencës që e boton ASHAK-u me ISBN ndërsa punimet e përzgjedhura origjinale mund të botohen në numrin e radhës së revistës “Research-Kërkime” që e boton ASHAK-u.

Bashkangjitur në ftesë gjeni edhe formatin e abstraktit të temës për prezantim.

Këshilli organizativ shkencor:

Akademik Fejzullah Krasniqi, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës

Akademik Neki Frashëri, Akademia e Shkencave të Shqipërisë

Akademik Isuf Krasniqi, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës

Akademie Anila Hoda, Akademia e Shkencave të Shqipërisë,

Anëtar korrespondent Fetah Podvorica, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës

Akademik Ilirjan Malollari, Akademia e Shkencave të Shqipërisë

Anëtare korrespondente Myzafer Limani, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës

Akademik Besnik Baraj, Akademia e Shkencave të Shqipërisë

Anëtar korrespondent Enver Hamiti, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës

Dr. Roza Allabashi, Universiteti i Resurseve Natyrore dhe Shkencave të Jetës, Vjenë, Austri

Prof. Dr. Niko Qafoku, Laboratori Kombëtar i Pacifikut Veri Perëndimor, Uashington, SHBA

Prof. Dr. Dhimitër Bello, Shkolla e Shëndetit Publik e Harvard-it, Boston, SHBA

Prof. Dr. Avdulla Alija, FSHMN, Universiteti i Prishtinës

Prof. Dr. Valbona Kolaneci, FBM, Universiteti Bujqësor i Tiranës

Prof. Dr. Majlinda Daci, FSHMN, Universiteti i Prishtinës
Prof. Dr. Majlinda Vasjari, FSHN, Universiteti i Tiranës
Prof. Dr. Avni Berisha, FSHMN, Universiteti i Prishtinës
Prof. Dr. Kledi Xhaxhiu, FSHN, Universiteti i Tiranës
Prof. Dr. Avni Hajdari, FSHMN,, Universiteti i Prishtinës
Prof. Dr. Naser Sahiti, FIM, Universiteti i Prishtinës
Prof. Dr. Magdalena Cara, FBM, Universiteti Bujqësor i Tiranës
Prof. Dr. Bashkim Thaçi, FSHMN, Universiteti i Prishtinës
Prof. Dr. Linda Grapci, FSHMN, Universiteti i Prishtinës
Prof. Dr. Ariola Bacu, FSHN, Universiteti i Tiranës
Prof. Ass. Lavdim Osmanaj, FIN, Universiteti i Prishtinës
Prof. Ass. Liridon Berisha, FSHMN, Universiteti i Prishtinës
Prof Asoc. Edlira Tako, Universiteti Politeknik i Tiranës
Prof. Ass. Flamur Sopaj, FSHMN, Universiteti i Prishtinës
Prof. Dr. Alma Shehu, FSHN, Universiteti i Tiranës
Dr. Rozarta Nezaj, FBM, Universiteti Bujqësor i Tiranës
Dr. Albana Veseli, FSHMN, Universiteti i Prishtinës
Dr. Nensi Isak, FSHN, Universiteti i Tiranës

.